



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 07.03.2014

P Ë R

ZGJERIMIN E ZONËS ME RËNDËSI TË VEÇANTË TË KURORËS SË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 3, 6, 8, 18/2, 26 dhe 32, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 221, datë 20.02.2013 "Për caktimin e zonave të brezit të gjelbërt të Tiranës dhe të rrethinave të tij", Vendimit të KKT-së nr. 3, datë 18.10.2013 "Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës" dhe VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013, "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Zgjerimin e zonës me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës, sikurse përcaktuar me Vendimin Nr. 3, datë 18.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese të zonës me rëndësi të veçantë të Kurorës së Tiranës", duke përfshirë në të edhe territorin administrativ të Komunës Petrelë, sipas hartës bashkëlidhur.
2. Pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore të ndërtimit si dhe pezullimin e planeve të detajuara vendore në territorin administrativ të Komunës Petrelë, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
3. Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, autoritetet e planifikimit lejohen të japin leje zhvillimore në territorin administrativ të Komunës Petrelë vetëm për këto raste përjashtimore:
 - a) Punime mirëmbajtje;
 - b) Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror ose kombëtar.
4. Ngarkohen Komuna Petrelë dhe autoritetet e tjera të planifikimit për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.



5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave / Ndërtimeve Informale dhe Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona.
6. Ngarkohen autoritetet e inspektimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENI

Eglantina Gjermeni

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA

Adelina Greca

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

